

129117 OSHEE

16.12.2020



4740 FTL

16.12.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER NATASHA Z. XHAÇKA
ADRESA NR.5, SAMI FRASHERI,
NR.3, NR.1, NR.12
TEL: 682094140

AKT MARRËVESHJE

(KONTRATE KALIMI E TE DREJTAVE REALE)

Nr. repertori: 1442

Nr. koleksioni: 609

Tirane më 16/12/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"

*Akti notarial përbëhet nga 9 fletë



A2020051330057482751



Sot, më datë 16.12.2020, para meje Notere NATASHA Z. XHAÇKA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, SAMI FRASHERI, NR.3, NR.1, NR.12, u paraqit personalisht, palët përfaqësuese për lidhjen e kësaj marrëveshjeje me objekt:

**MARRËVESHJE PËR NDARJEN E SHOQËRISË OSHEE SH.A. NËPËRMJET
TRANSEERIMIT TË AKTIVITETIT**

Kjo marrëveshje për ndarjen e shoqërisë "OSHEE" SH.A. nëpërmjet Transferimit të Aktivitetit lidhet midis:

Shoqërisë "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group" SILA. (OSHEE GROUP SH.A.), person juridik i së drejtës shqiptare, rregjistruar me vendimin Nr.38587, datë 19.06.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NUIS K72410014H, me seli në adresën: "Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë, Shqipëri, me kapital themeltar të regjistruar 29.936.709.000,00 Lekë (njëzet e nëntë miliard e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e nëntë mijë), përfaqësuar nga Administratori z.Adrian Çela, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (në vazhdim referuar si "**Transferuesi**").

Dhe

Shoqërisë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" SH.A., (këtu e më poshtë, referuar si "FTL" SH.A.), një shoqëri e krijuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 30.03.2018, me NUIS L81530029T, me seli në adresën: "Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H. 1, kati IV, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri", me kapital themeltar 3.500.000.00 Lekë (tre milion e pesëqind mijë), e përfaqësuar nga Administratori znj. Erina Rexhepi, shtetase shqiptare madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vazhdim referuar si "**Shoqëria pritëse**").

Secilit prej subjekteve të sipërpërmendur do t'i referohemi si "Palë", dhe bashkarisht atyre do t'u referohemi si "Palët".

Kushte Paraprake

- A. Në kuadër të reformës me qëllim liberalizimin e sektorit të energjisë dhe në zbatim të nenit 72 ligjit Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, (këtu më poshtë referuar si "Ligji i Energjisë"), Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të jetë i ndarë dhe i pavarur nga aktivitetet e tjera, të cilat nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike.
- B. Detyrimi për ndarjen e aktiviteve është sanksionuar gjithashtu edhe në VKM Nr. 519, datë 13.07.2016 "Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike".
- C. Mbështetur në Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, aksionari i vetëm i shoqërisë "OSHEE" SH.A., Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë ka marrë vendimin Nr. 458, datë 15.02.2017 "Për aprovimin e modelit të Korporatës";
- D. Në zbatim të urdhrit të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës me nr. 157, datë 12.02.2018 "Mbi krijimin e tre shoqërive të kontrolluara nga OSHEE SH.A.", janë krijuar tri shoqëri të reja të kontrolluara nga OSHEE SH.A. përkatësisht shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal" SH.A., Operatori i Sistemit të Shpërndarjes SH.A. dhe "Furnizuesi i Tregut të Lirë" SH.A. të regjistruara në regjistrin tregtar më datë 30.03.2018;



- E. Në vijim Enti Rregullator i Energjisë ka vendosur transferimin e licencës së FTL SH.A. në aktivitetin përkatës nëpërmjet: Vendimit Nr. 198, datë 03.09.2018 i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë "Mbi licencimin e shoqërisë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a, (FTL sh.a) në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike" dhe Vendimi Nr. 199, datë 03.09.2018 i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë "Mbi licencimin e shoqërisë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" SH.A., (FTL SH.A.) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike".
- F. Në datën 10.02.2020 Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve me Vendimin Nr.1192/2, datë 10.02.2020 ka miratuar Raportin e Audituesve Ligjorë për "Mbi miratimin e kalimit të llogarive inventariale dhe llogarive të arkëtueshme nga OSHEE SH.A. në tre Shoqërite "bija".
- G. Në datën 20.07.2020 Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë me Vendimin Nr.4992/1, datë 20/07/2020 ka miratuar Raportin e Audituesve Ligjorë për fazën e parë "Për ndarjen nëpërmjet transferimit të aktivitetit në tre shoqëri të reja të shoqërisë "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike" SH.A. (OSHEE SH.A.).

Sikurse u përshkrua më sipër është hartuar i gjithë kuadri ligjor për transferimin e aktiviteteve në sektorin e energjisë elektrike në kuadër të liberalizimit të sektorit të energjisë, aktivitete këto të ushtruara deri në 31 Dhjetor 2019 nga "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike" SH.A. (OSHEE SH.A.).

Duke qënë se aktualisht janë themeluar tre shoqëri të reja, të cilat do të ushtrojnë aktivitet në fushën e energjisë, Aktiviteti i Furnizimit me energji elektrike të klientëve fundorë që vepron në treg të rregulluar të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi do t'i kalojë shoqërisë së re të themeluar "Furnizuesi i Tregut të Lirë" SH.A., (këtu më poshtë referuar si "FTL" SH.A.).

Në përputhje me legjislacionin e përcaktuar në kushtet paraprake në vijim shoqëritë do të ushtrojnë këto funksione:

I. OSHEE GROUP SH.A.

Shoqëria OSHEE GROUP SH.A. do të vazhdojë të jetë një shoqëri "mëmë" për shoqëritë e kontrolluara, të ashtuquajtura shoqëritë "bija" dhe do të kryejë funksionet e mëposhtme:

- a. Të zotërojë dhe të mbikqyrë sipas kompetencës aktivitetin e shoqërive bija, me qëllim maksimizimin e performancës në përmbushje të objektit të aktivitetit të tyre.
- b. Të ofrojë shërbime për shoqëritë (bija) që zotëron lidhur me:
 - ü Shërbime Marrëdhënie me publikun
 - ü Shërbime Mbështetëse
 - ü Shërbime Teknologji Informacioni
 - ü Shërbime të Zhvillimit të Biznesit
 - ü Shërbime Ekonomike
 - ü Shërbime Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
 - ü Shërbime ligjore

II. FTL SH.A.

Shoqëria "FTL" SH.A. do të kryejë aktivitetet e mëposhtme:

- i. Të ofrojë blerjen dhe menaxhimin e energjisë, si dhe operimin në tregun e lirë.
- ii. Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe licencat e Shoqërisë të lëshuara nga autoritetet kompetente, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi, apo që ndërvaret ose lidhet me aktivitetet e renditura më sipër si dhe çdo lloj aktiviteti tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë.
- iii. Në varësi të termave dhe sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje, Transferuesi dëshiron të transferojë



një pjesë të aktivitetit siç përcaktohet në detaje më poshtë si një aktivitet i vazhdueshëm ndaj shoqërisë pritëse dhe kjo e fundit dëshiron të marrë aktivitetin nga Transferuesi, sipas kushteve të përcaktuara këtu;

- iv. Transferuesi dhe shoqëria pritëse kanë rënë dakord të ndërmarrin të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë Marrëveshje Transferimi Aktiviteti.

Në këto rrethana, duke mbajtur në konsideratë Kushtet Paraprake, të dyja shoqëritë miratojnë kushtet vijuese:

Neni 1

PËRKUFIZIME

Kushtet paraprake, Shtojcat dhe Aneksat janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje.

Në këtë Marrëveshje (duke përfshirë këtu Kushtet Paraprake dhe Shtojcat), fjalët vijuese do të kenë kuptimin e mëposhtëm, përveçse kur nga interpretimi i tekstit del se është përcaktuar ndryshe:

“**Marrëveshje**” nënkupton këtë marrëveshje

“**Shoqëri Transferuese e Aktivitetit**” në këtë Marrëveshje do të thotë shoqëria “**OSHEE GROUP**” SH.A.

“**Shoqëri pritëse**” në këtë Marrëveshje do të thotë shoqëria **FTL SH.A.**

“**Data Efektive e Transferimit**” është data 1 Janar 2020, datë në të cilën ka filluar nga aktiviteti ekonomik shoqëria **FTL SH.A.**

“**Data e Realizimit Përfundimtar të Transferimit**” do të thotë data e miratimit të Marrëveshjes nga Aksioneri i Vetëm i shoqërisë **OSHEE GROUP SH.A.** dhe i depozitimit të këtyre dokumentave në Qendrën Kombëtare të Biznesit, por kjo datë nuk mund të jetë përtej datës **31.12.2020.**

“**Barrë**” është çdo tarifë, garanci, peng, barrë siguroese apo privilegj mbi titullin e pronësisë apo çdo e drejtë garancie e palëve të treta si edhe çdo e drejtë e parablerjes apo kompensimi.

“**Vlera e Transferimit**” të aktivitetit

Shoqëria **FTL SH.A.** ka marrë përsipër detyrime dhe kapitale të veta në vlerë të barabartë me aktivet neto të përfituara nga ndarja. Vlerat e detyrimeve që do të likujdohen nga **FTL SH.A.** janë në aneksat nr.5 dhe 6 pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshje.

“**Data e Efektive**” është data e përcaktuar në paragrafin 3.1 të kësaj Marrëveshje.

“**Asete**” tregon Aktivitet Afatgjatë Materiale dhe Jomateriale, të luajtshme dhe të paluajtshme që do të transferohen nga **OSHEE GROUP SH.A.** tek **FTL SH.A.** gjendje në 1 Janar 2020, që do t'i bashkëlidhet kësaj Marrëveshje si Aneksi Nr. 1.

“**Pajisjet**” janë pajisjet e përcaktuara në Aneksin Nr.1 të kësaj Marrëveshje në sasi, kosto dhe amortizimin e akumuluar për çdo njësi deri në Datën Efektive.

“**Kod i Punës**” është Kodi i Punës Shqiptar i miratuar me ligjin Nr. 7961 datë 12 Korrik 1995, i ndryshuar.

“**Lëndët e para, Materialet dhe Mallrat**” janë lëndët e para, materialet dhe mallrat e përcaktuar në sasi dhe kosto magazine, të cilat janë gjendje në magazinat e **OSHEE SH.A.** dhe do të transferohen në datën 1 Janar 2020 tek **FTL SH.A.** sipas kësaj marrëveshje.

“**Punonjësit**” janë personat të cilët në 24 Dhjetor 2019 janë transferuar nga **OSHEE SH.A.** tek **FTL SH.A.**

“**Taksë**” është çdonjëra dhe të gjitha llojet e taksave, tatimeve, detyrimeve, kontributeve, tarifave doganore, të gjitha llojet e pagesave për kategorinë e taksave dhe të gjitha tatimet në burim, apo zbritjet që kanë të bëjnë me to, të çfarëdolloj natyre qofshin e kurdo që të aplikohen përfshirë këtu penalitetet.

Neni 2

OBJEKTI

2.1 “**OSHEE GROUP**” SH.A. i cedon dhe i transferon **FTL SH.A.**, që pranon, zërat aktiv dhe pasiv të bilancit të **OSHEE SH.A.** sipas gjendjeve në 01 Janar 2020 në vijim cilësuar:

- Aktivitet Afatgjatë Materiale, Pajisjet dhe Mobiljet të cilat janë përdorur nga Transferuesi për ushtrimin e aktivitetit të tij ekonomik para transferimit që kryhet nëpërmjet këtij akti;
- Lëndët e para dhe materialet gjendje në magazinë në Datën Efektive;
- Klientët dhe kërkesat e tjera të arkëtueshme sipas gjendjes në 1 Janar 2020,
- Punonjësit të cilët rezultojnë efektivisht të punësuar në Datën Efektive sipas kontratave përkatëse



- të punës.
- 2.2 Duke marrë parasysh sa më sipër, Palët deklarojnë se veprimtaria ekonomike që transferohet nëpërmjet OSHEE GROUP SH.A. ka një autonomi ekonomike dhe do të funksionojë si e pavarur tek FTL SH.A.
 - 2.3 Aktiviteti do t'i transferohet FTL SH.A. nga OSHEE SH.A. e lirë nga çdo Barrë dhe nga çdo detyrim i cilitdo lloji qoftë, me përjashtim të detyrimeve posaçërisht të përcaktuara në këtë Marrëveshje. Gjithashtu, transferimi i veprimtarisë kufizohet vetëm në asetet e përcaktuar në paragrafin 2.1 më sipër, duke përjashtuar shprehimisht çdo detyrim apo të drejtë të mëtejshme, zë aktiv i apo pasiv të regjistruar në bilanc, si dhe çdo raport tjetër juridik të cilët nuk janë shprehimisht të përcaktuar në këtë marrëveshje që mbeten në sferën e pronësisë dhe disponueshmërinë së "OSHEE GROUP" SH.A.
 - 2.4 Në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje është kryer çdo procedurë e transferimit të Punonjësve, sipas nenit 138 e 139 të Kodit të Punës. Duke filluar nga data 24 Dhjetor 2019 pjesa respektive e punonjësve kanë kaluar tek shoqëria FTL SH.A.

Neni 3

VLEFSHMËRIA E TRANSFERIMIT

- 3.1 Transferimi i aktivitetit fillon efektet nga data 1 Janar 2020 ("Data Efektive"). Duke nisur nga Data Efektive, FTL SH.A. do të disponojë lirisht aktivet dhe detyrimet dhe ka detyrimin për të shlyer të gjitha taksat dhe tatimet që i përkasin shoqërisë duke filluar nga kjo datë.
- 3.2 Nëse është e nevojshme dhe sipas rastit, "OSHEE GROUP" SH.A. angazhohet të ndërmarrë e të kryejë të gjitha veprimet e domosdoshme për të transferuar autorizimet e licencat në emër të FTL SH.A. për gjithë sa është ceduar nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, ku shpenzimet dhe detyrimet përkatëse do të përballohen nga FTL SH.A.

Neni 4

VLERE E TRANSFERIMIT

- Duke qenë se Shoqëria FTL SH.A. ka marrë përsipër pjesën e detyrimeve dhe kapitaleve të veta takuese nga ndarja dhe kjo vlerë është e barabartë me aktivet neto të përfituara. Vlerat e detyrimeve që do të likujdohen nga FTL SH.A. janë në anekset nr. 5 , 6 pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.
- 4.1 Edhe mbas këtij transferimi Kapitali i shoqërisë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" SH.A. (FTL SH.A.) do të vazhdojë të jetë 3.500.000 lekë i ndarë në 3.500 aksione me vlerë nominale 1.000 lekë/aksion. Aksioner i vetëm i shoqërisë FTL SH.A. do të vazhdojë të jetë "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group" SH.A. (OSHEE GROUP) e cila zotëron 100% të vlerës së aksioneve të shoqërisë.

Neni 5

AKTIVI DHE PASIVI PËR T'U TRANSFERUAR

- 5.1 Në kuadrin e këtij operacioni transferimi OSHEE GROUP SH.A. i transferon shoqërisë FTL SH.A. tërësinë e elementeve të aktivitetit e të pasivitetit gjendje më datë 01.01.2020. Grupet kryesore të këtyre aktiveve dhe pasiveve më datë 1 Janar 2020 që do të transferohen te shoqëria FTL SH.A. paraqiten si vijon:

Shoqëria FTL SH.A. bilanci i çeljes në 1 Janar 2020.

| FTL | Bilanci çeljes | Bilanci faza finale (Objektivi) |
|------------------------------|----------------|------------------------------------|
| 01 janar 2020 | 01 janar 2020 | |
| AKTIVE | | |
| Aktivet afatgjata | | |
| Aktivet afatgjata materiale | 19,346,452 | 19,346,452 |
| Aktive afatgjata jomateriale | 62,323,495 | 62,323,495 |
| E drejtë perdorimi | - | - |
| Aktive të tjera financiare | - | - |



| | | |
|---|---------------------|---------------------|
| Aktive Financiare investim në pjesëmarrje | - | - |
| Totali i aktiveve afatgjata | 81,669,947 | 81,669,947 |
| Aktivet afatshkurtra | | |
| Inventarë | 285,000 | 285,000 |
| Llogari të arkëtueshme tregtare neto | 0 | 0 |
| Llogari të arkëtueshme të tjera neto | 2,318,178 | 2,318,178 |
| Mjetet monetare në arkë e në bankë | - | - |
| Mjetet monetare të ngurtësuar | - | - |
| Totali i aktiveve afatshkurtra | 2,603,178 | 2,603,178 |
| Totali i aktiveve | 84,273,125 | 84,273,125 |
| KAPITALI | | |
| Kapitali aksionar/themeltar | - | - |
| Rezerva rivlerësimi asetesh | - | - |
| Rezerva të tjera | 2,921,675 | 2,921,675 |
| Humbje e akumuluar | (34,467,401) | (34,467,401) |
| Rezultati i i ushtrimit | (4,177,239) | (4,177,239) |
| Totali i kapitalit | (35,722,965) | (35,722,965) |
| DETYRIMET | | |
| Detyrime afatgjata | | |
| Hua afatgjata | - | - |
| Detyrime per qira financiare | - | - |
| Totali i detyrimeve afatgjata | - | - |
| Detyrime afatshkurtra | | |
| Pjesa afatshkurter e huasë afatgjatë | - | - |
| Hua afatshkurtra | - | - |



| | | |
|--|--------------------|--------------------|
| Llogari te pagueshme tregtare | - | - |
| Llogari te pagueshme tregtare ndaj KESH S.H.A | - | 70,292,688 |
| Detyrime ndaj OSHEE Llogari te pagueshme tregtare KESH S.H.A | 70,292,688 | - |
| Llogari te pagueshme tregtare ndaj OST S.H.A | - | 11,422,600 |
| Detyrime ndaj OSHEE Llogari te pagueshme tregtare OST S.H.A | 11,422,600 | - |
| Detyrime për taksa dhe sigurime shoqërore | - | - |
| Detyrime të tjera afatshkurtra | - | - |
| Detyrime për tatim fitimin | - | - |
| Provigjione | - | - |
| Detyrimi ndaj OSHEE sha nga ndarja | 38,280,802 | 38,280,802 |
| Totali i detyrimeve afatshkurtra | 119,996,090 | 119,996,090 |
| Totali i detyrimeve | 119,996,090 | 119,996,090 |
| Totali i kapitalit dhe detyrimeve | 84,273,125 | 84,273,125 |

5.2 Bilanci i celjes në kolonën e parë majtas me cmërtimin "Bilanci i celjes" 01 Janar 2020 janë pasqyruar të gjitha shumat e bilancit të ndarjes që duhet të kontabilizojë shoqëria FTL S.H.A. për vijimin normal të aktivitetit të saj. Në këtë kolonë detyrimet ndaj furnitoreve KESH S.H.A. dhe OST S.H.A. janë konsideruar detyrime ndaj "OSHEE GROUP" S.H.A. duke qenë se nuk janë bërë marrëveshjet përkatëse me KESH S.H.A. dhe OST S.H.A. për transferimin e këtyre detyrimeve të shoqëria e re FTL S.H.A.

Kurse kolona e dytë ka ndryshim vetëm në zerrat e që kanë të bëjnë me transferimin e detyrimeve të furnitorëve KESH S.H.A. dhe OST S.H.A. nga "OSHEE GROUP" S.H.A. për të FTL S.H.A. mbasi të jenë bërë të gjitha kontratat përkatëse dhe dokumentat e tjera ligjore të nevojshme me shoqëritë respektive.

5.3 Administratori i "OSHEE GROUP" S.H.A. dhe administratori i shoqërisë FTL S.H.A. nëpërmjet kesaj marrëveshjeje angazhohen se do të punojnë bashkërisht për të marrë të gjitha aprovimet e duhura me qëllim që detyrimet e mesiperme ndaj KESH S.H.A. në shumën 70,292,688 leke dhe OST S.H.A. në shumën 11,422,600 leke të njihen drejtëpërdrejt shoqërisë FTL S.H.A. dhe jo nëpërmjet OSHEE GROUP S.H.A.

5.3-Në kuadrin e këtij operacioni ndarjeje nëpërmjet transferimit, OSHEE GROUP S.H.A. i transferon shoqërisë FTL S.H.A. tërësinë e llogarive gjendje më datë 01/01/2020 sipas Anekseve nr 1-6.

Aneksi nr.1 - Përmbledhëse e Aktiveve afatgjata materiale, jo materiale dhe financiare që kanë kaluar pranë shoqërisë FTL S.H.A. nga ndarja.



Aneksi nr.2 Përmbledhëse e Llogarive inventariale që kanë kaluar pranë shoqërisë FTL SH.A. nga ndarja.

Aneksi nr.3 Përmbledhëse e Llogarive të arkëtueshme të tjera që kanë kaluar pranë shoqërisë FTL SH.A. nga ndarja.

Aneksi nr. 3/1 Analiza e llogarive Llogarive të arkëtueshme të tjera

Aneksi nr.4 Përmbledhëse e kapitaleve të veta që kanë kaluar pranë shoqërisë FTL SH.A. nga ndarja.

Aneksi nr.5 Përmbledhëse e Detyrimit ndaj OSHEE SH.A. (Llogarive të pagusheshme tregtare ndaj KESH SH.A. dhe OST SH.A.) që kanë kaluar pranë shoqërisë FTL SH.A. nga ndarja.

Aneksi nr.6 Përmbledhëse e Detyrimit ndaj OSHEE (Overdraft, furnitorë A-SH, detyrime tatimore, paga etj.) që kanë kaluar pranë shoqërisë FTL SH.A. nga ndarja.

Aneksi nr.6/1 Analiza e Detyrimit ndaj OSHEE SH.A. (Overdraft, furnitorë A-SH, detyrime tatimore, paga etj.) që kanë kaluar pranë shoqërisë FTL SH.A. nga ndarja.

5.4 Aneksat me nr 1,2, 3,3/1,4, 5, 6 dhe 6/1 janë pjesë integrale dhe të pa ndara të kesaj marrëveshjeje.

Neni 6 DATA KONTABËL

Në aspektin e kontabilitetit të gjitha operacionet e veprimtarisë së shoqërisë FTL SH.A. fillojnë nga data 1 Janar 2020 dhe i gjithë Aktiviteti i Furnizimit me energji elektrike të klientëve fundorë që veprojnë në treg të rregulluar të kryera prej shoqërisë FTL SH.A. nga data 1 Janar deri në datën e përfundimit të transferimit, do të konsiderohen si të kryera nga shoqëria pritëse FTL SH.A. dhe regjistrimet kontabël përkatëse do të merren në librat e saj.

Neni 7 GARANCITË E TRANSFERUESIT

- 7.1 "OSHEE GROUP" SH.A. deklaron dhe garanton se është i vetmi pronar dhe titullar i aktiveve (dhe të drejtave që rrjedhin prej tyre) dhe se OSHEE GROUP SH.A. ka zotësi të plotë për të lidhur dhe për të ekzekutuar këtë Marrëveshje.
- 7.2 OSHEE GROUP SH.A. deklaron dhe garanton se aktivet që po transferojnë janë të lira nga ndonjë Barrë apo çdo e drejtë tjetër në favor të të tretëve.
- 7.3 OSHEE GROUP SH.A. deklaron dhe garanton se nuk është objekt likuidimi, nuk është dhe nuk do të jetë objekt i një procedure falimentimi, si dhe nuk ka kërkesa për pranimin e saj në procedura falimentimi, apo kërkesa të tjera për likuidimin e detyruar, apo vullnetar të saj.
- 7.4 OSHEE GROUP SH.A. deklaron dhe garanton se, deri më datën e sotme nuk ka detyrime (të cilësdo natyre qofshin) ndaj të tretëve (persona fizikë apo persona juridikë, privatë apo shtetërorë, organe të qeverisjes lokale apo qëndrore, autoritete administrative, doganave apo fiskale), me përjashtim të atyre të pasqyruara në bilanc.
- 7.5 OSHEE GROUP SH.A. deklaron dhe garanton se, deri në datën e sotme, ka hartuar dhe paraqitur të gjitha deklaratimet fiskale, si dhe ka shlyer detyrimet përkatëse.
- 7.6 OSHEE GROUP SH.A. deklaron dhe garanton se të gjithë të Punësuarit janë marrë në punë rregullisht dhe janë paguar rregullisht për të gjithë punën e kryer gjatë marrëdhënies së punësimit, në përputhje me dispozitat ligjore të aplikueshme.
- 7.7 OSHEE GROUP SH.A. deklaron dhe garanton se Aktiviteti i transferuar nuk është përfshirë dhe nuk është pjesë e asnjë mosmarrëveshjeje gjyqësore ngritur përpara gjykatave apo kolegjeve të arbitrazhit, apo gjykimi administrativ.



- 7.8 OSHEE GROUP SH.A. deklaron dhe garanton se ka administruar dhe se do t'a administrojë deri në Datën Efektive aktivitetin e transferuar në përputhje me detyrimet e marra përsipër këtu, duke mos lidhur kontrata dhe kryer akte të cilat tejkalojnë kufijtë e administrimit të zakonshëm, apo që shkaktojnë apo do të shkaktonin në të ardhmen shkeljen e Garancive të Transferuesit apo që mund eventualisht të paragjykojnë përmbushjen e detyrimeve nga OSHEE GROUP SH.A.
- 7.9 Garancitë e Transferuesit konsiderohen të dhëna në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje dhe do të konsiderohen të përsëritura deri në datën efektive, duke përfshirë këtu të gjitha faktet dhe aktet që kanë lindur në harkun kohor të ndërmjetëm midis datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshje dhe Datës Efektive.
- 7.10 Në rast shkelje të garancive së mësipërme, OSHEE GROUP SH.A. shkarkon FTL SH.A. nga çdo përgjegjësi dhe merr përsipër ta mbajë atë të pacënuar nga çdo detyrim, kosto, dëm, pasivitet ose reduktim të pasurisë që mund t'i shkaktohet OSHEE GROUP SH.A. nga mungesa e vërtetësisë apo shkelja e këtyre garancive.

Neni 8

ANGAZHIME TË TJERA

- 8.1 Palët bien dakord dhe deklarojnë që do të hartojnë dokumentin për Marrjen në Dorëzim të Gjendjes Pasurore ku do të përfshijnë Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jo materiale, me vlerë kontabël dhe vlerë të mbetur në të tyre. Gjithashtu do të hartohet edhe dokumenti i marrjes në dorëzim të gjendjeve të inventarit (lëndë të para, materiale konsumi etj).
- 8.2 Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje OSHEE GROUP SH.A. do të vërë në dispozicion të FTL SH.A. të gjithë dokumentacionin (administrativ, kontabël, fiskal, doganor, pronësor, apo kontraktual etj.), i cili ka të bëjë me Aktivitetin e Transferuar njëkohësisht dhe jo më vonë se marrja në dorëzim, si parashikohet në paragrafin 6.1 më sipër. Në veçanti do t'i dorëzohen FTL SH.A. :
- (i) regjistri analitik i aktiveve dhe gjithë dokumentacioni kontabël që vërteton kostot e blerjes dhe amortizimin e akumuluar,
 - (ii) për Mallrat inventarin analitik që përcakton krahas sasisë edhe koston e magazinës për çdo artikull si edhe dokumentacionin kontabël që e vërteton këtë kosto,
 - (iii) për Klientë për shitje gjendjen analitike të tyre sipas sistemit të billingut,
 - (iv) si edhe çdo zhvlerësim të kryer nëse ka, për kërkesat e tjera të arkëtueshme dhe detyrimet e listat analitike që përputhen me gjendjen sipas pasqyrave financiare në 01 Janar 2020.
- 8.3 Për sa më sipër Palët deklarojnë dhe i garantojnë njëra-tjetrës bashkëpunim reciprok dhe transferim informacioni të plotë për plotësimin, hartimin dhe kryerjen e çdo deklarate të nevojshme në përgjithësi dhe në veçanti të çdo akti tjetër me natyrë fiskale e administrative. Palët angazhohen të informojnë mbi procedurat e transferimit Entin Rregullator të Energjisë, si dhe të përmbushin çdo detyrim ligjor kundrejt këtij të fundit.

Neni 9

TË NDRYSHME

- 9.1 Palët bien dakord dhe deklarojnë se transferimi i aktivitetit (i) është kryer në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare i ndryshuar" (ii) është kryer sipas nenit 16 të ligjit Nr. 92, datë 24.07.2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe konform Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 në zbatim të ligjit neni 21 i udhëzimit dhe se (ii) ky transferim nuk është subjekt i taksës mbi vlerën e shtuar - TVSH-së.
- 9.2 Asnjë ndryshim, shtesë, fshirje apo zëvendësim i kësaj Marrëveshjeje apo të kushteve të saj nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk do të kryhet me shkrim dhe nuk do të nënshkruhet nga të dy Palët që preken nga pjesa përkatëse e Marrëveshjes.
- 9.3 Në rast se një nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje (apo çdo dokument që referohet këtu) do të konsiderohet i paligjshëm, i pavlefshëm, i paefektshëm apo i pazbatueshëm, tërësisht apo pjesërisht, ligjshmëria, vlefshmëria, efektiviteti dhe zbatueshmëria e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje (apo këtij dokumenti) nuk do të ndryshojë apo çënohet në asnjë mënyrë nga dispozita në fjalë. Çdo dispozitë që do të konsiderohet e paligjshme, e pavlefshme, e paefektshme apo e pazbatueshme do të amendohet në formën që reflekton në mënyrë më të përafërt të mundshme qëllimin e dispozitës në fjalë, e cila do të jetë e vlefshme dhe e zbatueshme në vijim dhe Palët e kësaj Marrëveshjeje do t'a pranojnë atë ashtu siç do të ndryshohet.
- 9.4 Palët pranojnë dhe bien dakord se shpenzimet në lidhje me këtë Marrëveshje - përfshirë shpenzimet e



konsulencës ligjore apo profesionale - do të mbulohen përkatësisht nga Pala që ka kërkuar këto shërbime.
 9.5 Të gjitha njoftimet që do të kryhen në zbatim të kësaj Marrëveshje duhet të bëhen me postë rekomandë me kthim përgjigje, ose e-mail. Këto njoftime do të quhen se janë kryer në ditën e dërgimit për dërguesin dhe në ditën e marrjes për marrësin, nënkuptohet gjithashtu që ndryshimet e mundshme të adresave duhen t'i komunikohen palës tjetër brenda 15 ditëve nga data e ndryshimit.

Neni 10

LIGJI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI

- 10.1 Kjo Marrëveshje do të rregullohet, interpretohet dhe do të hyjë në fuqi në përputhje me Ligjin Shqiptar.
 10.2 Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet palëve në lidhje me interpretimin, vlefshmërinë dhe zbatimin e kësaj Marrëveshje do të zgjidhet ekskluzivisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 11

GJUHA

- 11.1 Kjo marrëveshje hartohet në 6 (gjashtë) kopje të njëjta në gjuhën shqipe nga 3 (tre) për secilën Palë.

- I. Kjo marrëveshje u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët me deklaruan se është në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, e kuptuan përmbajtjen e saj dhe e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë noterja verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumentave të identitetit dhe pasi gjeta përmbajtjen e aktit noterial të nënshpërm, në përputhje të plotë me nenin 62 e 63 të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrotjen e të Dhënave Personale", unë Noterja, deklaroj se do të ruaj dhe përputhë të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

"OSHEE GROUP" SH.A.

Adrian Çela
 Adrian ÇELA
 Administrator

"Furnizuesi i Tregut të Lirë" SH.A.

Erina Rexhepi
 Erina REXHEPI
 Administrator



NOTER
 NATASHA Z. XHAÇKA

Natasha Z. Xhachka